



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA DROPULL

DREJTORIA E SHËRBIMIT URBAN

RELACION TEKNIK

OBJEKTI:

“SHTRIM ME BETON I SEGMENTEVE TE RRUGES POLIÇAN - SOPIK “

2026

1. HYRJJE

Bashkia e Dropullit është një nga bashkitë e krijuara nga ndarja e re territoriale në vitin 2016. Ajo shtrihet nga jugu i qytetit të Gjirokastrës deri në kufirin Shqiptaro-Grek, përgjatë lumit të Drinos.

Bashkia e Dropullit përbëhet nga tre njësi administrative, **Dropull i Sipërm**, **Dropull i Poshtëm** dhe **Pogoni** dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 448.25 km².




Njesia Administrative e Pogonit ndodhet në pjesën jug-lindore të vendit. Përbëhet nga 7 fashtra me Policanin të jetë qendra e Njesisë Administrative.

Gjendja e rrjetit rrugor në **Njesinë Administrative të Pogonit** është shumë e amortizuar, pa pike ndërhyrjeje definitive, i cili sjell si pasoje që akseset në këto pjesë të Bashkisë së Dropullit të jetë shumë e vështirë.

Qëllimi i ndërhyrjes është që të bëhet rregullimi i sistemit të pjesës kaluese të rrugës që ka mbetur pa u shtruar nga fshati Policat deri në fshatin SOPIK për ofrimin e një lëvizjeje më të sigurtë dhe më të shpejtë të mjeteve dhe banorëve të kësaj Njesie Administrative.

Shuma e punimeve për rikonstruksionin e rrjetit rrugor kanë si qëllim të përmirësojnë afro 7400 m rrugë. Më pas paraqiten disa fotografi ku dallohet situata e rrjetit ekzistues rrugor.





2. PERSHKRIMI I PUNIMEVE

Llojet e punimeve qe do te kryhen per rikonstruksimin e rrjetit rrugor pershkruhen me poshte:

1. Germime per hapjen e kanaleve anesore pergjate rruges.
2. Germime per zgjerim rruge dhe vendosjen e tombinove.
3. Germime dhe mbushje me makineri per rehabilitimin dhe nivelimin e rruges perpara shtrimit me shtrese betoni.

4. Shtrimi me shtrese betoni 15 cm, C16/20 dhe vendosje zgare hekur me kuadrate 15 x 15 cm.

3. DETAJE KONSTRUKTIVE

Kategoria e betonit qe do te perdoret do te jete e klases C16/20. Sasia e cimentos qe korespondon per kete kategori eshte ~ 300 Kg cemento R 32.5 per 1 m³ beton. Trashesia e shtreses se betonit do te jete mesatarisht 15 cm e trashe. . Rruga ne keto segmente do te kete nje gjeresi normale 3.5 m dhe ne kthesat do te kete zgjerime qe do te arrije deri ne 5.0m.

Per perforcimin e betonit do te perdoret zgare hekur me permasa (2 x 5) m. me kuadrate (15 x 15) cm dhe trashesi (3-5)mm.

Tombinot e menjanimit te ujerave do te jene me diameter Ø 60 cm.




Fig 1. Segmenti 1 (Distance 1500 m.)



Fig 2. Segmenti II Fshati Skore - Sopik (Distance 5900 m).



Fig 3. Segmenti Hyrja ne fshatin Sopik



Fig 4. Segment

Nderhyrja parashikon shtrimin me beton te pjeses kaluese me gjeresi 3.5m.

Pjeserisht ka nderhyrje dhe ne veprat e artit vetem me vendosjen e tombinove ne perenjte qe nuk ka tombino e ne periudhat me reshje vershimi I perenjve bllokun kalimin e mjeteve dhe kembesoreve. Ky segment rrugor ka ne qarkullim edhe mjete te tonazhit te rende qe perdoren nga bizneset qe operojne ne kete zone si dhe banoret gjate ndertimeve qe kryejne. Tombinot egzistuese kane betone te demtuara ne portalet e hyrjes dhe portalet e daljeve. Do te parashikohen te rikonstruktohen.

SEMENTI I POLICAN – SKORE

Ka nje gjatesi prej 1500ml .Ne fillim do te behen veprat e artit (Tombinot) sipas planimetrise ne projektin e punimeve., germime per profilimin e gjerese se rruges ne parametrat e kerkuara(3.5)m, Shtresa e Stabilizantit ne kete segment varion nga (5-10)cm. Zgarat e hekurit do te vine te gatshme ne objekt e vendosja se bashku me lidhjen do te behet nga zbatuesi. Marka e betonit C16/20. Qarkullimi i cdo lloj mjeti pasi rruga te jete shtruar me beton do te behet pas 20(njezete) ditesh.

SEMENTI II SKORE - SOPIK

Ka nje gjatesi prej 5900 ml . Ne kete segment do te nderhyet edhe per zgjerimin e rruges duke germuar nga ana e bjefit te sperm ne nje gjatesi prej 80ml. Kanali do te vishet me beton me trashesi 10cm . Seksioni I kanalit i tipit trapezoidal. Dimensionet (b=50; B=150; H=50cm) baza ; Betonimi i kanalit do te behet njekohesisht me shtresen e betonit ne rruge. Kjo pjese e rruges ka

pjerresi mbi 12% gje qe e ben te domozdoshme veshjen e kanalit anesor me beton. Ne fillim do te behen veprat e artit (Tombinot) sipas planimetrise ne projektin e punimeve., germime per profilimin e gjerise se rruges ne parametrat e kerkuara(3.5)m, Shtresa e Stabilizantit ne kete segment varion nga (5-10)cm. Zgarat e hekurit do te vine te gatshme ne objekt e vendosja se bashku me lidhjen do te behet nga zbatuesi. Marka e betonit C16/20. Qarkullimi i cdo lloj mjeti pasi rruga te jete shtruar me beton do te behet pas 20(njezete) ditesh.

SHENIME

Sasia e materialeve te cimentos dhe te zgares se hekurit do te sigurohen nga Bashkia Dropull me denator te jashtem. Te gjitha zerat e tjere jane te llogaritura ne prenentivin perkates sipas Manualeve dhe analizave perkatese.

Ing. Gaqe Meçi

Ing. Arjan Tusha